

BULETIN INFORMATIV

Aktivitetet e muajit Janar 2026

www.cp-project.al info@cp-project.al



Seminar mbi "Përmirësimin e Sistemit të Statistikave të Rendit Publik"

Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA (PMT), në bashkëpunim me përfaqësues të Policisë së Shtetit, organizoi sesionin e parë të serisë së seminareve me titull "Përmirësimi i Sistemit të Statistikave të Prodhura dhe të Përdorura nga Strukturat e Rendit Publik".

Seminari mbledhi së bashku përfaqësues të strukturave të rendit publik si nga DPPSH ashtu edhe nga Drejtoritë Vendore të Policisë, duke përfshirë përfaqësues nga Drejtoria e TIK-ut. Drejtori i Drejtorisë së Rendit Publik dhe Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit SCPA iu drejtuan pjesëmarrësve, duke theksuar rëndësinë e mbajtjes së disa seminareve të grupeve të punës që synojnë përmirësimin e sistemit të statistikave të rendit publik. Seminari u organizua në kuadër të zbatimit të aktivitetit përkatës të planit të punës për përpunimin dhe rishikimin e kornizës së statistikave të policimit në komunitet dhe rendit publik. Ai u organizua në vijimësi dhe mbi takimet dhe seminarat e mëparshme të zhvilluara brenda këtij kuadri.


Ky sesion shënoi të parin në një seri seminaresh të Grupit të Punës që do të

organizohen bashkërisht nga Programi SCPA dhe strukturat përkatëse të PSH. Gjatë sesionit, sistemi aktual i raportimit të statistikave u shqyrtua dhe u krahasua me modelet e zgjedhura të BE-së. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me anëtarët e Grupit të Punës dhe me mbështetjen e ekspertëve të Programit SCPA, seminarat synojnë të ndërmarrin një vlerësim të strukturuar dhe të thelluar të sistemeve ekzistuese për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave të rendit publik dhe sigurisë. Qëllimi përfundimtar është konsolidimi i standardeve metodologjike dhe përmirësimi i sistemeve të të dhënave të përdorura nga Policia e Shtetit.

Përmes këtyre seminareve dhe rezultateve të tyre, Grupi i Punës i përbashkët synon të rrisë saktësinë, besueshmërinë, krahasueshmërinë dhe përdorimin efektiv të statistikave të rendit dhe sigurisë publike, duke mbështetur kështu vendimmarrjen strategjike dhe taktike, duke forcuar transparencën institucionale dhe duke përmirësuar monitorimin e performancës së policisë vendore.

AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Seminar mbi "Përmirësimin e Sistemit të Statistikave të Rendit Publik"
- ◆ Seminar mbi "Metodat dhe Praktikat Efektive për Zhvillimin e Temave për Rritjen e Ndërgjegjësisimit me Nxënësit"
- ◆ Thirrja Nr.2 për Aplikime në kuadër të Skemës së Granteve të programit SCPA
- ◆ Aktivitete në kuadër të mbështetjes nga Skema e Granteve
- ◆ NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjësuese në shkolla



Seminar mbi “Metodat dhe Praktikrat Efektive për Zhvillimin e Temave për Rritjen e Ndërgjegjësimit me Nxënësit”



Më 23 janar 2026, Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA, në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të Policisë së Shtetit, organizoi një seminar pune të dedikuar diskutimit dhe finalizimit të draft manualit “Metodat dhe Praktikrat Efektive për Zhvillimin e Temave për Rritjen e Ndërgjegjësimit me Nxënësit”.

Seminari mbledhi së bashku Shefin e Sektorit të Policimit në Komunitet pranë Drejtorisë së Rendit Publik, si dhe 10 Specialistë për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë, të cilët janë drejtpërdrejt të angazhuar në zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese në mjediset shkollore. Pjesëmarrësit kontribuan në mënyrë aktive në shqyrtimin e përmbajtjes së draft manualit, duke ofruar komente profesionale, sugjerime konkrete dhe shembuj praktikë nga përvoja e tyre

në terren. Në përfundim të diskutimeve, u arrit dakordësi mbi versionin përfundimtar të përditësuar të manualit, i cili pasqyron nevojat reale të punës me nxënësit dhe sfidat aktuale në mjediset shkollore.


Paralelisht, Koordinator i Programit dhe Specialistët për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë zhvilluan një proces të përbashkët rishikimi dhe përditësimi të moduleve të trajnimit në format PowerPoint. Këto module janë të orientuara drejt rritjes së ndërgjegjësimit të nxënësve mbi tema me rëndësi të veçantë, si:

- parandalimi i përdorimit të drogës,
- konsumimi i alkoolit dhe pirja e duhanit,
- bullizmi në shkolla,

- si dhe krimi kibernetik dhe siguria në internet.

Përditësimet u fokusuan në përmirësimin e qartësisë së mesazheve, përdorimin e metodave interaktive të të mësuarit, si dhe përshtatjen e materialeve me grupmoshat dhe realitetin e përditshëm të nxënësve.

Seminari përfundoi me një dakordësi të plotë mbi mjetet, qasjet dhe materialet e përmirësuara, si dhe me një angazhim të përbashkët për të forcuar më tej punën parandaluese



Thirrja Nr.2 për Aplikime në kuadër të Skemës së Granteve të programit SCPA

Programi “**Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri – SCPA**”, i financuar nga Qeveria Suedeze, gjatë muajit nëntor shpalli **Thirrjen Nr. 2 për Aplikime në kuadër të Skemës së Granteve**.

Shpallja ka pasqyruar detajet e mëposhtme për t’u pasur parasysh nga aplikuesit

Dokumentacioni & Afatet

- ⇒ Formulari i Aplikimit dhe Udhëzuesi: cp-project.al
- ⇒ Pyetje/sqarime: deri më **10 Dhjetor 2025** në grants@cp-project.al

⇒ Dorëzimi i aplikimeve: deri më **02 Janar 2026**, vetëm me email në grants@cp-project.al

Qarqet e zbatimit:

Qarqet: **Tiranë, Korçë, Kukës, Gjirokastrë**

Përfshihen jo vetëm bashkitë qendër qarku, por edhe bashkitë përbërëse (p.sh. Kamëz, Pogradec) dhe njësitë administrative të tyre.

Ky program mbështet zbatimin e reformës së policimit në komunitet dhe fton Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), konsorciume dhe organizata me bazë komunitare të dorëzojnë projekt-propozime.

Gjatë kësaj periudhe, programi SCPA ka përfunduar procesin e pranimit të aplikimeve dhe aktualisht ndodhet në fazën e zhvillimit të vizitave në çdo qark të vendit, pranë komisioneve vendore të përzgjedhjes. Këto komisione do të kryejnë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara të programit. Në përfundim të këtij procesi, projektet që plotësojnë standardet dhe kriteret e kërkuara do të shpallen zyrtarisht fituese të granteve dhe do të kalojnë në fazën e ardhshme të zbatimit.

Aktivite në kuadër të mbështetjes nga Skema e Granteve



Gjatë muajit **janar 2026** u zhvilluan disa aktivitete të rëndësishme në kuadër të forcimit të sigurisë publike, bashkëpunimit ndërinstytucional dhe përfshirjes së komunitetit, veçanërisht të të rinjve.

Në **Elbasan**, më 22 janar, Këshilli Vendor për Sigurinë Publike (KVSP) në bashkëpunim me organizatën **Tjetër Vizion** organizoi një takim bashkëbisedues me të rinjtë e Këshillit Vendor Rinor. Aktiviteti krijoi një hapësirë të hapur dialogu mbi sfidat e sigurisë në komunitet, duke theksuar rolin e të rinjve në parandalimin dhe raportimin e incidenteve, sidomos në shkolla. U prezantua gjithashtu aplikacioni online i zhvilluar nga projekti **PARTNER** për denoncimin e incidenteve në mjediset shkollore, si një mjet i sigurt dhe efikas raportimi. Gjetjet nga studimi i perceptimit qytetar për sigurinë publike në qark shërbyen si bazë për diskutime dhe orientim të politikave vendore.

Në **Kavajë**, më 20 janar, u

zhvillua një takim me rreth 50 nxënës të shkollës “**Fiqiri Kurti**”, në kuadër të Skemës së Granteve. Së bashku me stafin e shkollës dhe Policinë e Kavajës, u diskutua mbi paketën e sigurisë në shkolla dhe përmirësimin e mekanizmave të komunikimit dhe reagimit.

Nxënësit kontribuan aktivisht me ide dhe pyetje, duke reflektuar mbi rolin e tyre në parandalimin e incidenteve dhe rëndësinë e bashkëpunimit shkollë–polici–komunitet. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit për forcimin e mekanizmave vendorë të sigurisë në Qarkun Durrës.

Më 29 janar, në **Elbasan**, profesionistë nga 7 Ekipet Teknike Ndërdisciplinore (ETN) të bashkive të qarkut morën pjesë në një takim të organizuar nga Forumi Gruas Elbasan. U diskutuan raste konkrete dhe sfida në menaxhimin e tyre nga Gjykata, Prokuroria, Policia dhe koordinatoret vendorë kundër dhunës. Takimi shërbeu për ndarjen e praktikave

pozitive në trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore, duke forcuar koordinimin ndërinstytucional.

Ndërkohë, në **Malësi e Madhe**, KVSP zhvilloi një takim për prezantimin e rezultateve të Sistemit të Matjes së Sigurisë në Komunitet (SMSK) në kuadër të programit SCPA. Të dhënat nga anketimet evidentuan shqetësime konkrete të qytetarëve, duke nxitur diskutim mes institucioneve dhe hedhur bazat për plane veprimi të orientuara nga nevojat reale të komunitetit.

Këto iniciativa dëshmojnë se përfshirja e komunitetit, veçanërisht e të rinjve, përdorimi i mjeteve digjitale dhe vendimmarrja e bazuar në të dhëna po kontribuojnë në ndërtimin e komuniteteve më të sigurta, më të ndërgjegjshme dhe më bashkëpunuese.

NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjëse në shkolla



Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe në përputhje me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1076, datë 14.09.2022, "Për zbatimin e Programit 'Siguria e të Rinjve' në shkollat 9-vjeçare publike dhe jo publike," Ndhmës Specialistët e Policimit në Komunitet për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë kanë vijuar me përkushtim aktivitetet e tyre gjatë muajit **Janar, 2026.**

Objektivi kryesor i këtij programi është ngritja e ndërgjegjësimit të të rinjve kundër përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës.

Në kuadër të këtij programi, NSPK-të kanë bashkëpunuar ngushtësisht me koordinatorët vendorë të Zyrave Arsimore Vendore (ZAV), duke hartuar së bashku një kalendar të detajuar mujor për zhvillimin e temave në shkollat 9-vjeçare që ndodhen brenda zonave të tyre policore. Gjatë muajit janar, fokusi i veçantë ka qenë te temat

e ndërgjegjësimi kundër bullizmit dhe përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës të cilat përbëjnë prioritetet në edukimin e fëmijëve për mbrojtjen e jetës dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme në përditshmërinë e tyre.

Gjithashtu, janë trajtuar edhe tema të tjera që lidhen me edukimin qytetar, në bazë të kërkesave të komunitetit arsimor dhe situatave specifike të secilës zonë.

Përmes platformës online të monitorimit të aktiviteteve, është vërejtur një angazhim i shtuar nga ana e NSPK-ve që operojnë në komisariatet e qyteteve **Tiranë, Durrës Shkodër, Fier, Lushnje, Kukës Lezhë, Korçë, Pogradec, Elbasan, Kurbin, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë dhe Permet.**

Këto njësi kanë treguar një intensitet të lartë pune, duke realizuar takime të shumta dhe duke shpërndarë materiale ndërgjegjëse përmes rrjeteve sociale dhe forumeve online.

Në total, janë postuar **319** materiale dhe aktivitete që janë parë në mënyrë

interaktive nga **4397** përdorues, duke dëshmuar një interes të madh nga publiku.

Për më tepër, janë regjistruar gjithsej **130** komente në këto postime, të cilat në pjesën më të madhe kanë qenë pozitive, përshëndetëse dhe vlerësuese për punën dhe përkushtimin e treguar nga specialistët e Policisë së Shtetit.

